



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr.716/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje Goran Milenković - Kryetar, Nuhi Paçarizi - Referues dhe Blerim Dina – Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik N.T.SH.“EKOINVEST” në cilësinë e liderit të GOEN.T.SH. “EKOINVEST”; “VA ENGINEERING” GmbH, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë OE “ORA ENGINEERING” sh.p.k – Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërrimi i analizatorëve të oksigjenit B1 dhe B2 (Përmirësimi matjeve përmes modernizimit të aktuatorëve për flegtrat rregulluese të ventilatorëve thithës)”, me nr. të prokurimit “KEK-20-1029-5-2-1” iniciuar nga (AK) – “Korporata Energjetike e Kosovës” sh.a, me datën: 28.10.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik N.T.SH.“EKOINVEST” në cilësinë e liderit të GOEN.T.SH. “EKOINVEST”; “VA ENGINEERING” GmbH, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërrimi i analizatorëve të oksigjenit B1 dhe B2 (Përmirësimi i matjeve përmes modernizimit të aktuatorëve për flegtrat rregulluese të ventilatorëve thithës)”, iniciuar nga (AK) – “Korporata Energjetike e Kosovës” sh.a.

II. VËRTETOHET, njoftimi për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërrimi i analizatorëve të oksigjenit B1 dhe B2 (Përmirësimi i matjeve përmes modernizimit të aktuatorëve për flegtrat rregulluese të ventilatorëve thithës)”, iniciuar nga (AK) – “Korporata Energjetike e Kosovës” sh.a.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues N.T.SH.“EKOINVEST” në cilësinë e liderit të GOEN.T.SH. “EKOINVEST”; “VA ENGINEERING” GmbH, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesave në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues N.T.SH.“EKOINVEST” në cilësinë e liderit të GOEN.T.SH. “EKOINVEST”; “VA ENGINEERING” GmbH që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

AR SY ET IM

Operatori ekonomik N.T.SH.“EKOINVEST” në cilësinë e liderit të GOE N.T.SH. “EKOINVEST”; “VA ENGINEERING” GmbH, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 25.09.2020 me nr. 716/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë OE “ORA ENGINEERING” sh.p.k – Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërrimi i analizatorëve të oksigjenit B1 dhe B2 (Përmirësimi matjeve përmes modernizimit të aktuatorëve për flegat rregulluese të ventilatorëve thithës)”, me nr. të prokurimit: “KEK-20-1029-5-2-1” iniciuar nga (AK) – “Korporata Energjetike e Kosovës” sh.a, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 7, 27, 28, 56, 59, 60 dhe 69 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 09.10.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt:13.10.2020, lidhur me pretendimet ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

OE ankues pretendon se në këtë aktivitet të prokurimit publik nga ana e AK-së janë shkelur këto nene të LPP-së:

Neni 7: (Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi)

Neni 27: (Dosja e Tenderit)

Neni 28: (Specifikimet teknike)

Neni 56: (Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave)

Neni 59: (Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve)

Neni 60: (Kriteret për Dhënien e Kontratës)

Neni 69: (Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale)

Në këtë aktivitet të prokurimit publik për lidhjen e kontratës publike me një OE për punë, konkretisht AK ka kërkuar të bëjë Riparimin-restaurimin me anë të ndërrimit të Analizatorëve të oksigjenit B1 dhe B2 për të përmirësuar matjet duke e modernizuar-ndërruar Aktuatorin ekzistues për flegelat rregulluese të ventilatorëve thithës për rregullimin e gazrave të djegies së kaldajës tek blloqet e termocentralit Kosova B. Pra ndërrim, riparim dhe remont të pajisjeve ekzistuese duke planifikuar edhe pjesë rezervë për të njëjtat.

Janë dy pretendime ankimore të cilat kanë të bëjnë me arsyetimet e cekura në letrat standarde dhe njoftimin për vendimin e AK-së për eliminimin e OE ankues dhe arsyetimet e tij për eliminimin e ofertës së tij nga ana e AK-së, kinse e bërë në kundërshtim me dispozitat e LPP-së.

Të gjitha pretendimet e OE ankues janë shqyrtuar nga ana e **ekspertit teknik**, gjetjet, analizat dhe rekomandimet janë të paraqitura në vijim.

1. Në lidhje me pikën 1:

A). KERKESA NE DOSJEN E TENDERIT:

Modul ngasës i aktuatorit EBN 853

B). OFERTA E OFRUAR NGA OE:

Modul ngases i aktuatorit EBN 853 (Shih

bashkangjitur shtojca 1 – Katalogu i ofruar me oferte).

*Pra, qendrimi të cilit i referohet AK në pikën 1 në Letren Standarde për Tenderuesin e Eliminuar, nuk qendron. Të gjitha komentet shtese janë tendencë për të kamufluar dhe shpikur elemente të cilat nuk kerkohen me dosje të tenderit. Në dosje është kërkuar ngasja me EBN 853, nuk është kërkuar Aktuator, dhe nuk ka produkt tjetër në treg që mund të kryej shërbimin e kërkuar nga KEK përveç produktit të ofruar nga ne – EBN 853 dhe prodhuar nga ABB. – **Pretendimi 1***

Ky pretendim ndërlidhet me përshkrimin e arsyetimit të parë (nga tre të tilla të cekura nga AK në njoftimin mbi vendimin dhe letrat standarde) tek Njoftimi mbi vendimin e AK-së, **pika 1 e faktit 2** të kësaj ekspertize, ku cekët që: *Poëer elektronika e ofruar EBN 853 është për aktuator standard të prodhuar nga ABB tip RHDE8000-80. Shpejtesia e Poëer elektronikes së ofruar është 80 sekonda që është për 20 sekonda më shumë se sa që nevojitet për aktuatorin ekzistues RH800-60 të prodhuar nga S&F, pra shpejtesia më e vogël që është ofruar është diku rreth 33% më e vogël se sa që është kërkesa në DT.*

Ventilatori thithës është pajisje e ndjeshme dhe kjo nënkupton direkt çrregullime të gazrave që nxirren nga kaldaja dhe kjo shkakton çrregullime në punën e blloqeve.


Po ashtu kjo Poëer Elektronike e ofruar nuk mund të inkorporohet me motorrin me flanaxhe dhe bosht special adekuat për aktuatorin e vjetër RH800-60.

Me analizimin e kësaj pike ankimore, kontrollimit të dosjes së tenderit dhe specifikacionit teknik të saj e po ashtu ofertën e dorëzuar nga OE ankues së bashku me katalogun e dorëzuar, eksperti teknik sqaron si në vijim.

AK ka kërkuar modernizimin e sistemit të rregullimit automatik të flegrove rregulluese të ventilatorit thithës që nënkupton largimin e pjesëve të sistemit të vjetër rregullues dhe zvogëlimin e këtyre pjesëve. AK ka kërkuar remontimin total të aktuatorëve ekzistues dhe instalimin e ngasësve elektronik për këta aktuator, pra është kërkuar poëer elektronikë – ngasje me **EBN 853** e jo aktuator si produkt, e kjo është e qartë edhe nëse shikohet **fakti 3** i kësaj ekspertize, ngase AK tashmë posedon që më shumë se 20 vite me aktuatorin e **“RH800-60”** të prodhuesit **“Schoppe & Faeser” GmbH**, i cili për shkak të vjetërsisë është pothuajse e pamundur për AK të siguroj pjesë rezervë për ndërrim dhe riparim te tij në treg.

Të dy operatorët të cilët kanë dorëzuar ofertat e tyre në këtë AP kanë ofertuar me produkte të prodhuesit **ABB** i cili që nga 1999 e ka përfshirë brenda grupacionit të tij të kompanive edhe ndërrmarjen **“Schoppe & Faeser” GmbH** dhe për produktet e vjetra të tij ofron produkte të reja alternative siç është e cekur edhe në linkun dhe foton në vijim.

<https://global.abb/group/en/about/history/heritage-brands/schoppe-faeser>



Në faqen 19 të dokumentit me titull **“TD_p2.pdf”** konfirmon me hijëzim se me cilin produkt ka ofertuar OE ankues. Si në foton në vijim:

EBN853 for Ex-Actuators

Basic model	V68853	XXXX	XXX	XXX	XXX	XXX	XXX	XXX
EBN853 Electronic Unit for Ex-Actuators, for field installation								
Suitable for							Continued see next page	
Linear Actuator RSDE10-5,0/100		2076						
Linear Actuator RSDE10-5,0/300		9176						
Linear Actuator RSDE10-10,0/100		2077						
Linear Actuator RSDE10-10,0/300		9177						
Linear Actuator RSDE20-5,0/100		2078						
Linear Actuator RSDE20-5,0/300		9178						
Linear Actuator RSDE20-7,5/100		2079						
Linear Actuator RSDE20-7,5/300		9179						
Linear Actuator RSDE50-3,0/120		3080						
Linear Actuator RSDE50-3,0/300		9180						
Part-Turn Actuator RHDE250-10		0110						
Part-Turn Actuator RHDE500-10		0119						
Part-Turn Actuator RHDE800-10		0120						
Part-Turn Actuator RHDE1250-12		0128						
Part-Turn Actuator RHDE2500-25		0129						
Part-Turn Actuator RHDE4000-40		0157						
Part-Turn Actuator RHDE8000-80		0158						
Supply Voltage								
230 V AC 1 Ph		380						
115 V AC 1 Ph		381						
Frequency								
50 Hz					382			
60 Hz					383			
Digital Communication								
RS 232						384		
RS 232 + HART®						385		
PROFIBUS DP®						386		
PROFIBUS DPV1®						387		
Electrical Connection to Actuator								
Without cable (plug at standard actuator, terminal connection at Ex actuator)							335	
With cable set (specify length) (Additional cost: 32.30 Euro per m)							695	

Po ashtu e konfirmoj ekzistencën e dokumentit të mëposhtëm i cili dokument i është bashkangjitur ankesës se OE ankues dhe i cili është i lëshuar nga prodhuesi i produktit



ABB Automation Products GmbH, Schillerstr. 72, D-72425
Hindesheim

To whom it might concern

PERSON IN CHARGE

Stephan Schulze

UNIFORM

IFS

PHONE

+49 571 830 1638

MOBILE

+49 160 939 749 25

E-MAIL

stephan.schulze@de.abb.com

OUR REFERENCE

IFS / H&B actuators

PAGE

1/1

DATE

April 02, 2020

Dear Sirs,

We hereby confirm that the old actuator series

- R5Txxx
- RHxxx RH800-80
- RHAXxx
- R5xxx

are faced out since years.

The today series of Contrac actuators

- PMExxx
- RHExxx RHDE8000-80
- LMExxx
- RSDxxx

are the successor types.

These Contrac actuators offering significant improvements in combination with the well-known robustness of the H&B actuators.

We are looking forward to a good business-relationship and are confident that you will be convinced by the quality of our products.

Best regards,

Dr. Wolfgang Scholz
Head of Quality Assurance

Stephan Schulze
Product Line Manager A&P

I cili dokument e konfirmon që produkti i ofertuar nga OE ankues është seri e re e “*Contrac Aktuatoreve*” të ofruar nga prodhuesi ABB.

Me krahasim të Poëer elektronikës së produktit të ofertuar nga OE ankues dhe produktit të kërkuar nga AK, pra produktit *RHDE8000-80* me produktin *RH800-60* si në fotot dhe linkun më poshtë: [https://library.e.abb.com/public/03b01603e87c4c998b78d7574622a9a5/DS_CONTRAC_UPGRADE](https://library.e.abb.com/public/03b01603e87c4c998b78d7574622a9a5/DS_CONTRAC_UPGRADE_EN_C.pdf)

[EN C.pdf](https://library.e.abb.com/public/03b01603e87c4c998b78d7574622a9a5/DS_CONTRAC_UPGRADE_EN_C.pdf)

	RHD8000-12	RHD8000-80
Nominal torque	8000 Nm (5900 lbf-ft), adjustable to 0.5, 0.75 or 1 × nominal torque	
Starting torque	1.2 × nominal torque (break-away torque in end positions for short time 2 × nominal torque)	
Rated time for 90°; adjustable	12 to 900 s Rapid traverse mode with control motor max. 10 s/90°	80 to 900 s
Rated operating speed, adjustable	7.5 to 0.1 °/s Rapid traverse mode with servo motor max. 9 °/s	1.12 to 0.1 °/s
Operating angle	Typically 90° (min. 35°; max. 270°), see manual for reduced angle with lever and limit stop	
Weight	Approx. 710 kg (1565 lb)	Approx. 705 kg (1554 lb)
Associated electronic unit	For field mounting: EBN8E1 For rack installation: EBS8E2	For field mounting: EBN8E3 For rack installation: EBS8E2
Motor	MC 112 BA	MC 90 BA
Sensors	Position and temperature sensor always available	

DHE.

Electronics for field-mounting EBN8E3 (IP 66)

For rotary actuator	Nominal torque	Rated operating speed	Type before conversion	Ordering number	Code
RHC 12-10	120 Nm	9.0°/s (10 s/90°)	RST 12-10 RH 12-10	V68853	0535
RHC 25-10	250 Nm	9.0°/s (10 s/90°)	RST 25-10 RH 25-10	V68853	0536
RHC 25-30	250 Nm	3.0°/s (30 s/90°)	RST 25-30 RH 25-30	V68853	0537
RHC 40-10	400 Nm	9.0°/s (10 s/90°)	RST 40-10 RH 40-10	V68853	0538
RHC 60-10	600 Nm	9.0°/s (10 s/90°)	RST 60-10 RH 60-10	V68853	0539
RHC 60-30	600 Nm	3.0°/s (30 s/90°)	RST 60-30 RH 60-30	V68853	0540
RHC 60-60	600 Nm	1.5°/s (60 s/90°)	RST 60-60 RH 60-60	V68853	0541
RHC 125-10	1250 Nm	9.0°/s (10 s/90°)	RST 125-10 RH 125-10	V68853	0542
RHC 125-30	1250 Nm	3.0°/s (30 s/90°)	RST 125-30 RH 125-30	V68853	0543
RHC 125-60	1250 Nm	1.5°/s (60 s/90°)	RST 125-60 RH 125-60	V68853	0544
RHC 200-30	2000 Nm	3.0°/s (30 s/90°)	RST 200-30 RH 200-30	V68853	0545
RHC 250-60	2000 Nm	1.5°/s (60 s/90°)	RST 250-60 RH 250-60	V68853	0546
RHC 400-30	4000 Nm	3.0°/s (30 s/90°)	RST 400-30 RH 400-30	V68853	0547
RHC 400-60	4000 Nm	1.5°/s (60 s/90°)	RST 400-60 RH 400-60	V68853	0548
RHC 800-60	8000 Nm	1.5°/s (60 s/90°)	RST 800-60 RH 800-60	V68853	0549

Me foton:

For rotary actuator	Nominal torque	Rated operating speed	Ordering number	Code
RHB 250-10	250 Nm	9,0°/s (10 s/90°)	V68853	0101
RHB 250-30		3,0°/s (30 s/90°)	V68853	0102
RHB 500-10		9,0°/s (10 s/90°)	V68853	0111
RHB 500-30	500 Nm	1,5°/s (60 s/90°)	V68853	0112
RHB 800-15		6,0°/s (15 s/90°)	V68853	0113
RHB 800-35		2,5°/s (35 s/90°)	V68853	0114
RHB 1250-12	1250 Nm	7,5°/s (12 s/90°)	V68853	0121
RHB 1250-35		2,5°/s (35 s/90°)	V68853	0122
RHB 1250-60		12,5°/s (60 s/90°)	V68853	0123
RHB 2500-25	2500 Nm	3,6°/s (25 s/90°)	V68853	0124
RHB 2500-45		2,0°/s (45 s/90°)	V68853	0125
RHB 2500-70		1,3°/s (70 s/90°)	V68853	0126
RHB 4000-40	4000 Nm	2,25°/s (40 s/90°)	V68853	0131
RHB 4000-70		1,25°/s (70 s/90°)	V68853	0132
RHB 8000-80	8000 Nm	1,12°/s (80 s/90°)	V68853	0133

Nga këto foto shihet se shpejtësia e operimit është **1.5°/s ose (60s/90°)** pra produkti i ofertuar nga OE ankues është për **20s** më i shpejtë se ai ekzistuesi dhe si i tillë nuk është kompatibel me ekzistuesin, gjithashtu konfirmohet nga këto foto që prodhuesi **ABB** ofron produkt që i plotëson në plotëni kërkesat e AK-së. I njëjti arsyetim është dhënë edhe nga komisioni rivlerësues, shpejtësi kjo e cila shkakton probleme në nxjerrjen jashtë të gazrave dhe rrjedhimisht në funksionimin e mirëfilltë të blloqeve të termocentralit, andaj të njëjtin arsyetim e përkrahim edhe ne dhe për këtë arsye **pretendimin ankimor 1** e konsideroj **si të pabazuar**.

Përgjigje në pretendimin ankimor 2... B) OFERTA NGA OE: Ne kemi ofruar referencen nga partneri i Konzorciumit VA – Engineering GmbH (shih shtojca numër 7) ne te cilën shihet qarte se OE ka bere liferimin dhe instalimin (pra implementimin e suksesshëm te projektit), për pajisjen e njëjtë sikur pajisja e kërkuar nga KEK – EBN 853 (shih bashkangjitur shtojca 2).

Eksperti teknik pas kontrollimit të ofertës së OE ankues dhe **faktit 1** të kësaj ekspertize – kërkesat për plotësimin e kapacitetit teknik dhe profesional ku nga AK kërkohet: “1.Operatori Ekonomik duhet të prezantojë së paku 1 (një) referenca apo certifikata mbi përfundimin e punëve nga punëdhënësi mbi implementimin e suksesshëm të projekteve për tri vitet e shkuara nga data e publikimit të njoftimit për kontrat me kontaktet për verifikim, me një fushëveprim të ngjashëm të punëve, me këtë aktivitet të prokurimit nga ku mund të shihet kapaciteti teknik dhe përvoja e tij.

Për mendimin tim letra konfirmuese e mëposhtme është dokument i mjaftueshëm për dëshmim të përvojës së anëtarit të konzorciumit, e cila përmban shënime të blerësit, furnitorit për pajisje, ndër te tjera edhe ato pajisje me të cilat ka ofertuar OE ankues në këtë aktivitet të prokurimit. Në këtë letër konfirmim shënon blerja dhe montimi, ndërsa arsyetimi i AK-së që duhet të jetë referencë për upgrade, modernizim, përshtatje nuk do të thotë që diku tjetër në botë kanë teknologji si tek ne dhe që duhet medoemos të kenë referenca për punë të tilla identike por duhet të përdoret termi te natyrës së ngjashme.

To whom it may concern

23.04.2020

CONFIRMATION LETTER

3P Automation declares that during the period 2017- 2020 we bought the following equipment incl. assembly from VA-Engineering GmbH:

Description	PCs.
Motor BG 100	1
DS-Motor MCS71 BA	1
Positioner S4+4K	1
Power Unit EBN861	1
Positioner S2 + HZ	2
Positioner S2+4K(GOLD)+HZ	2
Motor M163LT	1
Motor GNM 2130	5
Positioner S2 /68996-2-0000/511	3
DS-Motor MCS71 BA	1
Power Unit EBN853	1
Motor MCS80 BA	1
Motor BG 90	1
Motor BG 112	1
Positioner, kompl.	2

The total amount is 61.500 EUR (VAT not included).

We declare that we have no complaints about this equipment.


3P AUTOMATION GMBH
Langer Kamp 13, D-54636 Biersdorf am See
phone: 0170 9397952
fax: 0170 9397955

Për **pretendimin 2** mendoj që AK ka vepruar në kundërshtim me nenët 7 dhe 59 të LPP-së dhe të njejtin e konsideroj si të bazuar.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Duke u bazuar në faktet, hulumtimet, krahasimet, sqarimet dhe të gjeturat tjera të cekura në këtë ekspertizë, eksperti shqyrtues dhe ai teknik i propozojnë Panelit Shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si **pjesërisht e bazuar** dhe të mbeten në fuqi vendimi i AK-së i datës 11.09.2020.

Autoriteti Kontraktues nuk e ka njoftuar OSHP-në se pajtohet apo jo me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik me datën 15.10.2020 me anë të parashtresës, e ka njoftuar OSHP-në se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Sqarime shtese:

Te nderuar anëtar te OSHP,

Faleminderit për email dhe raportin e ekspertit shqyrtues.

Arsyetimet e dhëna “nga eksperti shqyrtues” ne pretendimet ankimore, nuk qëndrojnë dhe ose nuk po kuptohen

1. EBN853 është interfejsi mes njësive kontrolluese dhe aktuatorit, por nuk është aktuator.

Shpejtësisë të cilës i referohet eksperti shqyrtues nuk është shpejtësi e produktit të ofruar EBN853 - por është shpejtësi e aktuatorit RHC800-40. NE KEMI OFERTUAR ME Poëer Electronics EBN853 dhe jo me aktuator RHC800-40. Ju lutemi të i referoheni manualit të Poëer Electronics, të paisjeve të kërkuara me TDS, dhe jo shpejtësisë së aktuatoreve apo emetimit të gazrave në elektranë.

2. Ngasësi elektrik (Poëer elektronika) EBN853 – **nuk ka shpejtësi**. Momenti i rrotullimit / kryerja e një qarku punues / një vijë punuese përcaktohet nga **aktuatori egzistues (800-60, 800-80... XXX)**.

Pra konstatimet që **EBN853** i prodhuar nga **ABB** dhe i ofertuar nga NTSH Ekoinvest është për 20 sekonda më i shpejtë (ose me i ngadalshëm), se **EBN853** i prodhuar nga **ABB** por i ofertuar kompania e propozuar për shpërbllim me kontratë – janë ose jo-profesionale ose tendencioze, por ne shpresojmë që nuk është kuptuar mirë TDS nga eksperti shqyrtues.

Pra, nëse dëshironi të shpërbleni me kontratë një OE me produktin e njëjtë por me cmim 7.5% më të lartë, atëherë mund ta bëni këtë veprim, por ju rikutojmë që të dy ofertat janë për produktin saktësisht të njëjtë, të prodhuesit të njëjtë!

Për me tepër, ne kemi ofruar katalog te plote për këtë produkt siç kërkohet me pike 9.1 dhe 9.2 te TDS, ndërsa dokumentet e përmendura ne vlerësimin e ekspertit shqyrtues, te cilave u referohet si foto, nuk janë pjesë e katalogut të ABB për EBN853, nuk e dimë çfarë dokumenti është ai ne foto – por nuk është katalogu origjinal i cili gjendet ne TDS tone.

Prandaj nuk pajtohemi ne asnjë formë me mendimin e ekspert shqyrtues, dhe kërkojmë seance për këtë aktivitet prokurimi.

Me respekt,

Ntsh Ekoinvest

Me datën 16.10.2020 Eksperti teknik me email i drejtohet Bordit si me poshtë:

I nderuari Kryetar te nderuar anëtar te bordit,

Dua te konfirmoj se qëndroj prapa rekomandimeve te cekura ne ekspertizen time te lendes 716/20, e kam kuptuar mire dhe qarte edhe DT edhe pretendimet e OE ankues, kjo jo sepse jam Inxhiner i Diplomuar i Elektroteknikes ne Drejtimin Automatike dhe Elektronike me pervojë gati 15 vjecare, por te gjitha kerkesat e AK dhe permbajtja e DT jane shume te qarta dhe nuk eshte dashur shume hulumtim per t'iu pergjigjur!

Ne ekspertize jane te cekura me detaje informatat dhe te gjeturat, aty une kam thene qe te dy OE kan ofertuar me produkte te Prodhuesit te njejte, eshte edhe historiku i pajisjes me te cilen posedon AK, gjithashtu nuk e

diskutoj e as nuk e kam cekur askund qe "Poëer Electronics" (eshte pajisje per sigurim te burimit te energjise qe i nevojitet aktuatorit per te funksionuar) te te dy OE jane EBN853 sepse kete e ka kerkuar vete AK, po problemi qendron te remonti i Aktuatorit te vjeter me te cilin posedon AK dhe per te cilin nuk ka mirembajtje e as nuk prodhohet, kete aktuator ka kerkuar AK qe te kaloj-modifikohet-remontohet quaje si te duash ne nje pajisje te re per te cilen ka pjese rezerve dhe mund te vazhdoje te mirembahet...

Aq sa i kam pare dosjet ketu OE ankues ka ofertuar (mund ta shihni katalogun e dorezuar ne oferten e tij e ka rrethuar produktin RHDE8000-80), qe nenkuptohet nese kontrata i jepet OE ankues pasi te behet remont aktuatori ekzistues i AK-se (RH800-60) do kaloj ne RHDE8000-80, qe gjithqka do te ishte ne rregull edhe cmimi me i lire edhe prodhuesi i njejte, perpos se...numri 60, 80 etj (jane linqet krahasuese te nxjerra nga ëebfaqja e prodhuesit dhe te krahasuara me katalogun e dorezuar nga OE ankues), tregojne kohen e kryerjes se nje cikli te punes dhe hapjen/mbylljen e ventillave-pistonave per ta nxjerre oksigjenin-gazrat qe krijohen-dalin nga termoelektranat dhe ketu paraqitet problemi pasi qe poëer elektronika qe e udheheq nje aktuator i cili i obligon pistonat te kryejne nje cikel pra te hapen per 60 sekonda ose per 80 sekonda edhe pse eshte e njejte me karakteristika te njejta nuk reagon njejte te nje Aktuator qe i hape pistonat cdo 80 sekonda dhe tek nje aktuator i cili i hape cdo 60 sekonda (te cilen gje e ka kerkuar AK).

Shpresoj qe nuk e kam zgjatur dhe besoj qe kam arrite ta sqaroj thelbin me pak fjale ashtu siq e kam kuptuar edhe une.

Me respekt,

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 28.10.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit teknik të prokurimit dhe të gjithë parashtrësit e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues N.T.SH.“EKOINVEST”, që ka të bëjë me përshkrimin e arsytimit të parë (nga tre të tilla të cekura nga AK në njoftimin mbi vendimin dhe letrat standarde) tek Njoftimi mbi vendimin e AK-së, ku cekët që: *Poëer elektronika e ofruar EBN 853 eshte per aktuator standard te prodhuar nga ABB tip RHDE8000-80. Shpejtesia e Poëer elektronikes se ofruar eshte 80 sekonda qe eshte per 20 sekonda me shume se sa qe nevojitet per aktuatorin ekzistues RH800-60 te prodhuar nga S&F, pra shpejtesia me e vogel qe eshte ofruar eshte diku rreth 33% me e vogel se sa qe eshte kerkesa ne DT.*

Ventilatori thithes eshte pajisje e ndjeshme dhe kjo nenkupton direkt çrregullime te gazrave qe nxirren nga kaldaja dhe kjo shkakton çrregullime ne punen e blloqeve. Po ashtu kjo Poëer Elektronike e ofruar nuk mund te inkorporohet me motorrin me fllanxe dhe bosht special adekuat per aktuatorin e vjeter RH800-60.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit teknik sqaron se AK ka kërkuar modernizimin e sistemit të rregullimit automatik të flegrove rregulluese të ventilatorit thithës që nënkupton largimin e pjesëve të sistemit të vjetër rregullues dhe zvogëlimin e këtyre pjesëve. AK ka kërkuar remontimin total të aktuatorëve ekzistues dhe instalimin e ngasësve elektronik për këta aktuator, pra është kërkuar poëer elektronikë – ngasje me EBN 853 e jo aktuator si produkt, ngase AK tashmë posedon që më shumë se 20 vite me aktuatorin e “RH800-60” të prodhuesit “Schoppe & Faeser” GmbH, i cili për shkak të vjetërsisë është pothuajse e pamundur për AK të siguroj pjesë rezervë për ndërrim dhe riparim të tij në treg. Paneli Shqyrtues sqaron se të dy operatorët të cilët kanë dorëzuar ofertat e tyre në këtë aktivitet të prokurimit kanë ofertuar me produkte të prodhuesit ABB i cili që nga 1999 e ka përfshirë brenda grupacionit të tij të kompanive edhe ndërrmarjen “Schoppe & Faeser” GmbH dhe për produktet e vjetra të tij ofron produkte të reja alternative siç është e cekur edhe në linkun dhe foton të cilën e ka bashkangjitur eksperti teknik në raportin e tij. Po ashtu, Paneli Shqyrtues sqaron se eksperti teknik ka sqaruar se në faqen 19 të dokumentit me titull “TD_p2.pdf” konfirmon me hijëzim se me cilin produkt ka ofertuar OE ankues, ku është bashkangjitur fotoja me të dhëna teknike në ekspertizë. Po ashtu, eksperti teknik e ka konfirmuar në ekspertizë ekzistencën e dokumentit të bashkangjitur në raport, i cili dokument i është bashkangjitur ankesës se OE ankues dhe i cili është i lëshuar nga prodhuesi i produktit, ku ky dokument e konfirmon që produkti i ofertuar nga OE ankues është seri e re e “Contrac Aktuatorëve” të ofruar nga prodhuesi ABB. Me krahasim të Poëer elektronikës së produktit të ofertuar nga OE ankues dhe produktit të kërkuar nga AK, pra produktit RHDE8000-80 me produktin RH800-60 si në fotot dhe linkun më poshtë: https://library.e.abb.com/public/03b01603e87c4c998b78d7574622a9a5/DS_CONTRAC_UPGRADE_EN_C.pdf

Pra, Paneli Shqyrtues sqaron se nga fotot e bashkangjitura në ekspertizë shihet se shpejtësia e operimit është 1.5°/s ose (60s/90°) pra produkti i ofertuar nga OE ankues është për 20s më i shpejtë se ai ekzistuesi dhe si i tillë nuk është kompatibil me ekzistuesin. Gjithashtu, konfirmohet nga këto foto që prodhuesi ABB ofron produkt që i plotëson në plotëni kërkesat e AK-së. I njëjti arsyetim është dhënë edhe nga komisioni rivlerësues, shpejtësi kjo e cila shkakton probleme në nxjerrjen jashtë të gazrave dhe rrjedhimisht në funksionimin e mirëfilltë të blloqeve të termocentralit. Andaj, ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

Sa i përket pretendimit tjetër të OE ankues N.T.SH. “EKOINVEST”, ku potencon: *Ne kemi ofruar referencen nga partneri i Konzorciumit VA – Engineering GmbH (shih shtojca numër 7) ne të cilën shihet qarte se OE ka bere liferimin dhe instalimin (pra implementimin e suksesshëm të projektit), për pajisjen e njëjtë sikur pajisja e kërkuar nga KEK – EBN 853 (shih bashkangjitur shtojca 2).*

Paneli Shqyrtues konform ekspertit teknik sqaron se pas kontrollimit të ofertës së OE ankues dhe sqarimeve në pikën e parë, kërkesat për plotësimin e kapacitetit teknik dhe profesional ku nga AK kërkohet: “1.Operatori Ekonomik duhet të prezantojë së paku 1 (një) referenca apo certifikata mbi përfundimin e punëve nga punëdhënësi mbi implementimin e suksesshëm të projekteve për tri vitet e shkuara nga data e publikimit të

njoftimit për kontrat me kontaktet për verifikim, me një fushëveprim të ngjashëm të punëve, me këtë aktivitet të prokurimit nga ku mund të shihet kapaciteti teknik dhe përvoja e tij.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit teknik sqaron se letra konfirmuese e bashkangjitur në raportin e ekspertit është dokument i mjaftueshëm për dëshmim të përvojës së anëtarit të konzorciumit, e cila përmban shënime të blerësit, furnitorit për pajisje, ndër te tjera edhe ato pajisje me të cilat ka ofertuar OE ankues në këtë aktivitet të prokurimit. Në këtë letër konfirmim shënon blerja dhe montimi, ndërsa arsyetimi i AK-së që duhet të jetë referencë për upgrade, modernizim, përshtatje nuk do të thotë që diku tjetër në botë kanë teknologji si tek ne dhe që duhet medoemos të kenë referenca për punë të tilla identike por duhet të përdoret termi të natyrës së ngjashme. Andaj, ky pretendim ankimor është i bazuar.

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe sqarimeve të ekspertit teknik, vjen në përfundim se autoriteti kontraktues në përgjithësi ka bërë vlerësimin e tenderëve në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit dhe neni 59 të LPP-së, me përjashtim të disa devijimeve të vogla të cilat nuk paraqesin ndonjë ndryshim material. Megjithatë, në bazë të sqarimeve të ekspertit teknik, Paneli Shqyrtues konsideron se autoriteti kontraktues përmes këtij aktiviteti të prokurimit ka arritur qëllimin konform nenit 1 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Goran Milenković

Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK "Korporata Energjetike e Kosovës";
- 1x1 OE N.T.SH."EKOINVEST";
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.